



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
OSNOVNI SUD U PRIZRENU - BASIC COURT OF PRIZREN

AD-GJTHPZ.nr.13/24

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Kryetarja e gjykatës Shpresa Emra, duke vepruar sipas kërkesës Për inicim të procedurës disiplinore të parashtruar nga ana e ankueses E.B.:, nga Prizreni, respektivisht të përfaqësuesit të saj av.B.K., nga Prizreni, ndaj gjyqtarit A.B.:, gjyqtar në Gjykatën Themelore në Prizren, Departamentin e Përgjithshëm - Divizioni Civil, lidhur me veprimet dhe sjelljen e gjyqtarit sipas lëndës civile C.nr.648/24, ne bazë të Së cilës është bërë inicimi i procedurës disiplinore, me dt. I I .10.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e ankueses E.B.:, nga Prizreni, respektivisht të përfaqësuesit të saj av.B.K., nga Prizreni, ndaj gjyqtarit A.B.:, gjyqtar në Gjykatën Themelore në Prizren, Departamentin e Përgjithshëm - Divizioni Civil, lidhur me veprimet dhe sjelljen e gjyqtarit sipas lëndës civile C.nr.648/24.

A r s y e t i m

Parashtruesi i ankesës av.B.K., me date 16.09.2024 ka parashtruar kërkesë Për inicim të procedurës disiplinore ndaj gjyqtarit A.B.:, gjyqtar në Gjykatën Themelore ne Prizren, Departamentin e Përgjithshëm-Divizioni Civil, lidhur me veprimet dhe sjelljen e gjyqtarit sipas lëndës civile C.nr.648/24.

Ankuesi av.B.K., në kërkesën e paraqitur ka deklaruar se në vitin 2024 është paraqitur lënda C.nr.648/24 nga paditësja E.B.:, Për kualifikim kundër të paditurës Komuna e Prizrenit. Gjyqtari i çështjes Për shkak të mungesës Së provës (listës Së pagave) pa shqyrtim kryesor duke u bazuar qëllimisht gabim të neni 399 i LPK-së ka nxjerrë vendim Për shkak të mungesës Së listës Së pagës ta refuzoj padinë në tërësi, duke pretenduar se gjyqtari gabimisht i ngatërron "faktet" me "provat". Gjyqtari qëllimisht e ngatërron termin fakt me termin provë, pasi që provat palë ndërgjyqësi mund t'i bashkëngjisnin deri në përfundim të shqyrtimit përgatitor dhe

nuk lejohet që të nxirret vendim pa shqyrtim kryesor të çështjes nëse nuk është bashkëngjitur në shkresat e lëndës një provë e cekur në referat të padisë. Madje gjyqtari i çështjes nuk ia ka dërguar palës paditëse, përgjigjen në padi e palës se paditur duke ia pamundësuar që ta shikojnë se cilat fakte kanë qenë të kontestuar nga pala e paditur. Me këtë rast ka shkelur parimin e kontradiktoritetit dhe parimin e barazisë së armëve të paraparë me nenin 5 par. I të LPK-së. Po ashtu, ky gjyqtar i nxjerr vendimet për refuzimin e padive, ku i ka trajtuar lëndët e vitit 2024, ndërsa lëndët që duhet t'i aprovoj të viteve 2023, 2022, 2021 e të para shumë viteve as që i prek. Ky është fakt notor që ky gjyqtar i vonon lëndët shumë, madje aktgjykimin nuk e sjellë për 4 apo 5 vite. Po ashtu, gjyqtari në fjalë e dërgon praktikanten e gjykatës në zyrën e avokatit për t'i treguar që do të refuzohen paditë për mungesë të një prove.

Autoriteti kompetent - Kryetarja e gjykatës pasi që ka pranuar ankesë ndaj gjyqtarit A.B., gjyqtar në Gjykatën Themelore në Prizren, Departamentin e Përgjithshëm - Divizioni Civil, lidhur me lëndën C.nr.648/24 ka iniciuar hetimet preliminare për procedurë disiplinore dhe ka ndërmarrë disa veprime në këtë drejtim. Fillimisht ka bërë shikimin në ankesën e parashtruar, ka kërkuar deklaratë nga gjyqtari i çështjes.

Gjyqtari në deklaratën e tij lidhur e pretendimet e ankuesit ka cekur se të itha pretendimet e avokatit B.K., janë të pavërteta. Është e vërtet që atë lëndë e ka vendosur jashtë seance, mirëpo kjo mënyrë e vendosjes është qëndrim i përgjithshëm dhe vlejnë për të gjitha gjykatat në Republikën e Kosovës lidhur me kontestet nga marrëveshja kolektive. Sa i përket pretendimit të dytë që ka dërguar praktikanë në zyrën e tij, ky është një trillim i avokatit, është shpifje e tij, me qëllim të njollosjes së personalitetit të tij, për çka gjyqtari do të ndjekë rrugët ligjore sa i përket gënjeshtreve dhe trillimeve që paraqet ky avokat me qëllim të degradimit të personalitetit të tij. Me këtë avokat asnjëherë nuk ka komunikuar edhe kur e ka takuar nëpër korridore të gjykatës. Konsideron që nga vetë paragrafi i tretë në fund të ankesës, nëse ai paragraf lexohet më vëmendje ka elemente të veprës penale të kanosjes ndaj personit zyrtarë e gjitha kjo me qëllim të frikësimit të tij. Nëse avokati mendon që proceduralisht nuk ka respektuar dispozitat ligjore, të gjitha shkeljet ka mundur t'i paraqet përmes ankesës, e jo të merret me personalitetin e tij dhe procedura disiplinore. Kërkon nga autoriteti kompetent që përveç që ta refuzoni këtë ankesë të këtij avokati, për veprimet e avokatit B.K., të njoftohet edhe Oda e Avokatëve e edhe Këshilli Gjyqësorë, pasi që është i vetmi gjyqtar që ballafaqohet me pretendime të pavërteta të tij, e gjithë kjo me qëllim të frikësimit të gjyqtarëve. Andaj, propozon që ankesa të refuzohet si e pabazuar.

Autoriteti kompetent - Kryetarja e gjykatës pasi që ka pranuar deklaratën nga gjyqtari i çështjes, ka bërë verifikimin e shkresave të lëndës C.nr.648/24.

Pas vlerësimit dhe analizës së tërësishme të provave të mbledhura Autoriteti Kompetent konsideron se:

Ankesa është e pabazuar.

Autoriteti kompetent - Kryetarja pas verifikimit të gjithë dokumentacionit ka vërtetuar gjendjen faktike si vijon:

Në Gjykatën Themelore në Prizren — Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me datë 01.02.2024 është parashtruar padia e paditëses E.B., nga Prizreni, të cilën me autorizim e

përfaqëson av.B.K., nga Prizreni kundër të paditurës Komuna e Prizrenit — DKA, me Objekt të kontestit kompensimin e diferencës së pagës së kualifikimit të pa paguar, e Cila është e evidentuar me shenjë C.nr.648/24. Gjykata në këtë çështje me datë 19.06.2024 ka marrë aktvendim me të cilin e ka ftuar paditësen që të bëjë pagesën e taksës gjyqësore në afat prej 3 ditëve, përndryshe padia do të konsiderohet e tërhequr. Në këtë drejtim, i autorizuari i paditëses av.B.K., dëshminë për pagesën e bërë ka dorëzuar në gjykatë. Pas kësaj, gjykata ka vazhduar me procedurën e rregullt duke dërguar vërejtje Për përgjigje në padi të paditurës Komuna e Prizrenit — DKA e Cila me date 28.06.2024 kësaj gjykate ia ka dorëzuar përgjigjen në padi. Gjykata, pas arritjes Së përgjigjes ne padi në bazë të nenit 399 paragrafi I të LPK-së, e Cila parasheh se "Kur gjykata, pasi t'i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do të jep vendimin meritor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia. ", ka marrë aktgjykim me të cilin e ka refuzuar si te pabazuar kërkesëpadinë e paditëses E.B:.,

Sa i përket pretendimeve te ankuesit av.B.K., të gjitha janë të pabazuara pasi që gjyqtari i çështjes ka marrë aktgjykim duke u bazuar në dispozitat ligjore të LPK-së dhe praktikës Së përgjithshme gjyqësore. Në veprimet e gjyqtarit nuk qëndron asnjë Shkelje disiplinore siç pretendohet nga ana e avokatit, Për me tepër avokati në fjalë ndaj aktgjykimit te lartcekur ka të drejtën e ankesës në Gjykatën e Apelit e Cila si gjykatë e shkallës Së dytë vendos Për shkeljet e supozuara procedurale dhe vendimin meritor të gjyqtarit. Për pretendimet tjera të avokatit gjykata nuk ka prova dhe konsideron se gjuha e komunikimit e avokatit është joprofesionale dhe ka të bëjë me pretendimet personale të cilat nuk mund të shqyrtohen ne këtë procedure.

Andaj, si Autoritet Kompetent bazuar në të lartcekura konsideron se gjyqtari A.B:; ne veprimet e tij nuk ka pasur Shkelje të cilat konsistojnë me shkeljet disiplinore të parapara me Ligjin Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve ku është paraparë Shkelje sa i përket sjelljes, qoftë kur është ne detyrë apo privatisht, të cilat dëmtojnë reputacionin e gjykatës ose mund të dëmtojnë besimin e publikut në paanshmërinë ose besueshmërinë e gjyqësorit.

Për arsyet e cekura më lartë, Autoriteti Kompetent — Kryetarja e Gjykatës ka vendosur si në dispozitiv të aktvendimit në kuptim të nenit 9 paragrafi 6 lidhur me nenin 17 paragrafi 5 te Ligjit nr.06/L-057 Për përgjegjësinë disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN

AD-GJTHPZ.nr.13/2024, me dt.11.10.2024



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi nuk është e paraparë e drejta e ankesës.